

## Diploma

Kodi i lëndës	Semestri	Kreditet e lëndës				Kredite
		Leksione	Ushtrime/ Seminare	Laboratore	Diploma	
	VI	-	-	-	6	6
<b>Sasia e orëve: auditor/ jashtë auditorit</b>		-	-	-	30/120	30/120
<b>Sasia e orëve: Total</b>		-	-	-	150	150

### Objektivat

Punimi i diplomës ka për qëllim të ofrojë, për studentët në fushën e inxhinierisë elektronike një kulturë bazë inxhinierike të sistemeve elektronike dhe aplikimeve në to. Gjithashtu ka për qëllim që i diplomuari të brumoset me të menduarit kritik në mënyrë që të mos shikojë vetëm aspektet e projektimit të sistemeve elektronike apo elementeve të tyre përbërës, por edhe ato të dimensionimit dhe menaxhimit optimal të tyre. Përsa i përket formimit në fushën e mirëfilltë të inxhinierisë elektronike punimi i diplomës duhet të përmbajë njohuri mbi elementët bazë të sistemeve elektronike; arkitekturën e tyre, si dhe projektimin e elementëve përbërës të sistemeve elektronike; arkitekturën e rrjetave dhe protokolleve të transmetimit të të dhënave, aplikimet e sistemeve elektronike në industri dhe aplikimet e rrjetave me sensorë.

### Njohuritë dhe aftësitë që përfitohen nga përvetësimi i diplomës

Diploma zhvillohet në semestrin e dytë, në vitin e tretë, pranë laboratoreve të departamentit, ose pranë kompanive, institucioneve apo organizatave, aktiviteti i të cilave mbështetet në teknologjitë e lidhura me fushën e sistemeve elektronike dhe aplikimeve të tyre.

Me fitimin e krediteve të saj studenti duhet të jetë i aftë:

Të merret me projekte, zbatime dhe mirëmbajtje të sistemeve përpunues të informacionit, të sistemeve elektronike si dhe të rrjetave me sensorë.

Të drejtojë laboratore të përpunimit të informacionit të ndërmarrjeve, apo kompanive që punojnë në industri, në fushën e mjekësisë, apo të mjedisit.

Të merret me aktivitete të promovimit, shitjes, asistencës teknike dhe të profesionistit të lirë në fushën e inxhinierisë elektronike.

Të përdorë njohuritë e marra në shkollë, për përdorimin e tyre efikas në sistemet praktike të lidhura me sistemet elektronike dhe çdo fushë të aplikimit të tyre.

Të kryejë analizën teorike/analitike të problemeve dhe interpretimin e fenomeneve që lidhen me ecurinë dhe përpunimin e sinjaleve në sistem dhe mjedisin e transmetimit.

Diploma e Ciklit të Parë "Bachelor" i jep mundësinë mbajtësit të saj për vazhdimin e studimeve në programet e ciklit të dytë (studimet master i shkencave ose master profesional).

Për të vazhduar studimet në programet e ciklit të dytë, master i shkencave në Inxhinieri Elektronike dhe në fusha të afërta me të, kandidati duhet të ketë fituar notën mesatare të ponderuar: 7 (shtatë) deri në 10 (dhjetë).